

1. Burimet financiare të Urdhrit të Stomatologut janë:

a) kuotizacionet e anëtarëve;

b) tarifat e regjistrimit dhe të dhënies së të drejtës individuale për ushtrimin e profesionit, vërtetime dhe dokumente të tjera, për të cilat urdhri mban evidencë zyrtare;

c) donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

Të ardhurat e siguruara sipas përcaktimit të bërë në pikën 2, të këtij neni, Urdhri i Stomatologëve i përdor për të përmbushur misionin e tij në përputhje me statutin dhe me këtë ligj.